



## Smaltoplast Elastic

**Bojë e Testuar Ekologjike me veti kundër kërpudhave**



**Rendimenti i mbulimit: 11 - 13 m<sup>2</sup>/lt**



**Koha e tharjes: 2 - 4 orë**



**Hollimi: 8-10 % në ujë**



**Mundësia për shtresë të dytë: 6 - 8 orë**



**Paketimi: 3 lt, 10 lt**

**Aplikimi: Furçë, rul, pistoletë me spërkatje**

### KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

Bojë muri elastomere e testuar ekologjike, me cilësi të shkëlqyer 100% akrilike, rezistente ndaj ujit me veti kundër kërpudhave. Me pak aromë. E përshtatshme për lyerjen e mureve të jashtme të reja apo të rilyera, suvave, sipërfaqeve të trasha dhe betonit. Ideale për hidroizolimim e muraturave dhe sipërfaqeve me çarje dhe krisje të vogla deri në 1 mm si dhe për rinovimin e sistemeve të jashtme të izolimit termik. Siguron përgjigje të shkëlqyer në variacione të mëdha të temperaturës, duke ruajtur elasticitetin e saj në temperatura të ulëta deri në -20°C pa u ciflosur në kushte moti me ngricë. Mban në mënyrë të reduktuar ndotësit për shkak të mekanizmit të veçantë të forcimit në prani të rrezeve të diellit (ndërlidhja UV), e cila eliminon pothuajse çdo ngjitje. Ngjitje dhe rezistencë e shkëlqyer ndaj rrezatimit ultraviolet dhe alkaleve. Mbron shtresën me bojë kundër rritjes së mykut dhe kërpudhave, veçanërisht në sipërfaqet me probleme lagështie. Punohet me lëmim, përhapet mrekullisht dhe siguron efikasitet dhe mbulim të lartë. Përmbajtje e reduktuar e përbërësve organikë të avullueshëm (POA).

<b>Shkëlqimi</b>	Mat kadifeje me një indeks shkëlqimi prej 6°<10 njësi në 85°.
<b>Graviteti specifik</b>	1,35 - 1,50 kg/lt në varësi të nuancës së ngjyrës.
<b>Hollimi</b>	8-10 % për vëllim në ujë. Hollimi duhet të jetë i kufizuar për të mbuluar çarje më të mëdha.
<b>Rendimenti i mbulimit</b>	11-13 m <sup>2</sup> /lt për shtresë, në varësi të sipërfaqes.
<b>Koha e tharjes</b>	Thahet për 2 deri në 4 orë. Boja fiton rezistencën e saj të plotë ndaj larjes pas 3-4 javësh.
<b>Mundësia për shtresë të dytë</b>	6-8 orë. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta dhe me lagështirë të motit.
<b>Klasa e POA</b>	"Bojëra për mure të jashtme me substrate mineralesh". Lloji Y. Vlera e pragut të POA = 40 g/lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 20 gr/lt.
<b>Ngjyra</b>	E bardhë dhe në mijëra nuanca ekologjike përmes sistemit të krijimit të nuancave COLOR MOOD nga VECHRO.
<b>Rezistent ndaj ujit</b>	Produkti konsiderohet "i papërshkueshëm" nga uji sipas DIN EN 1062-3.
<b>Rezistencë ndaj mykut</b>	Produkti ka rezistencë të shkëlqyer ndaj rritjes së mykut sipas EN15457.
<b>Rezistenca ndaj konsumimit të përsheptuar, dëmet nga kushtet e motit QUV</b>	Nuk ka probleme me çarjen, rryepjen, flluskat, pluhurin apo çngjyrosjen (ISO 16474-3, ISO 4628)



<b>Ngjitja</b>	Forca e shkëputjes > 4,68 MPa (ISO 4624)
<b>Ngjyrat</b>	E bardhë dhe në mijëra nuanca ekologjike përmes sistemit të krijimit të nuancave COLOR MOOD nga VECHRO.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQËS

Pastroni plotësisht sipërfaqet nga pluhuri, vajrat, bojërat e mëparshme, pjesët e lirshme, mbetjet e mykut, etj. Smeriloni lehtë sipërfaqen.

Sipërfaqet e lyera me gëlqere, ngjitës, bojëra të vjetra ose sipërfaqet e reja janë lyer fillimisht me astar Smaltoplast Universal Primer. Sipërfaqet që kanë nikotinë, tymra, tym duhani, stilolaps me furçë, bojë, kërpudha, myk, lagështirë, vaj, njolla të shkrimeve në mur, ose sipërfaqet e vjetruara lyhen fillimisht me SMALTOX hidro. Në sipërfaqet me çarje më të mëdha se 1 mm, kërkohet të mbushet paraprakisht çarja me mbushës për çarjet, me stuko elastomere ose stuko me shumë.

## APLIKIMI

Përzieni mirë përpara përdorimit. Për të mbuluar kapilarët dhe çarjet deri në 0,5 mm, aplikoni 2 shtresa Smaltoplast Elastic dhe për çarjet më të mëdha se 0,5 mm aplikoni tre shtresa të produktit në raportin më të ulët të mundshëm të hollimit.

Minimizon shpërdorimin e bojës: për një sipërfaqe prej 10 m<sup>2</sup> dhe me dy shtresa, do t'ju duhet 1,6 lt bojë.

**Këshillë!** Reduktoni numrin e përgjithshëm të shtresave me nuancë të errët me aplikimin paraprak të SMALTOX hidro ose SMALTOPLAST elastic në një nuancë gri S 1502-Y për aplikimin e nuancave të verdha, S 1502-R për nuanca të kuqe, etj. ose në një nuancë të së njëjtës ngjyrë duke përdorur një bazë më të errët.

## PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në kuti dhe pastrojini menjëherë ato me ujë të ngrohtë me sapun. Nëse boja thahet, ajo mund të hiqet vetëm me detergjente të fortë.

## KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8 - 30 °C dhe niveli relativ i lagështisë më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

## RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni fort enën pas aplikimit. Rimerreni bojën që ka tepruar për ta përdorur përsëri. Ngjyrat e ripërdorura mund të minimizojë shumë efektet mjedisore të ciklit të jetës së produktit.

## SHËNIME

Përmban biocide [ZnPy (13463-41-7), TERBUTRYN (886-50-0) & OIT (26530-20-1)] për të mbrojtur shtresën nga rritja e kërpudhave. Mos e ndotni ujë-mbajtësin gjatë ose pas përdorimit. Përmban OIT dhe CIT / MIT. Mund të shkaktojë alergji.

Plotëson kriteret për marrjen e etiketës ekologjike 312/2014/KE.

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve.